

KARTA E APOSTOLLIT PAVEL MBË FILIMONINË

Krye 1

¹ Pavli, i-lidhurë i Jisu Krishtit, edhe Timotheu, vëllaj, mbë Filimonin' e-dashurë edhe bashkëpunëtorinë t'ënë, ² Edhe mb' Apfin' e-dashurë, edhe mb' Arhipnë bashkëushtëtorinë t'ënë, edhe mbë kishënë ndë shtëpit t'ënde; ³ Hir qoftë mbë ju e paqtim prej Perëndisë, Atit t'ënë, edhe prej Zotit Jisu Krisht. ⁴ I falem ndersë Perëndisë t'im, dyke prurë ndër mëntt ty përherë ndë të-falurat të mia, ⁵ Sepse dëgjonj për dashurinë t'ënde edhe për besënë që ke mbë Zotinë Jisu, edhe mbë gjithë shënjtorëtë; ⁶ Që të bënetë shoqëria e besësë s'ate e-pemshime me anë të të-çfaqurit të çdo së-mire që është ndër ju mbë Jisu Krishtinë. ⁷ Sepse kemi shumë gëzim edhe ngushillim për dashurinë t'ënde, sepse zëmërat' e shënjtorëvet janë prëjturë me anë t'ënde, o vëlla. ⁸ Përandaj, ndonëse kam shumë kuxim mbë Jisu Krishtinë të të urdhëronj ty atë që duhetë, ⁹ Po për dashurinë më tepërë të lutem, dyke qënë i-atillë që jam, si plaku Pavël, po ndashti edhe i-lidhurë i Jisu Krishtit. ¹⁰ Të lutem për birinë t'im, që më lindi ndër të-lidhurat të mia, për Onisiminë; ¹¹ I-cili qe njëherë i-vëjyerë te ti, po ndashti është i-vëjyerë për ty edhe për mua, të-cilinë e dërgova përsëri. ¹² Edhe ti prit-e atë, do-me-thënë zëmërenë t'ime. ¹³ Unë desha t'a mbanj atë për anë vetëhesë s'ime që të më shërbenjë ndë vëntt t'ënt, ndë të-lidhurat të ungjillit; ¹⁴ Po pa mëndjenë t'ënde nukë desha të bënj asgjë, që të mos jet' e-mira jote si prej nevoje, po prej dashjeje. ¹⁵ Sepse mbase përandaj unda prej teje për pak kohë, që t'a kesh atë për jetë; ¹⁶ Jo më si shërbëtuat, po më tepërë se shërbëtuat, vëlla të-dashurë, veçan tek unë, po sa më tepërë te ti edhe pas mishit edhe mbë Zotinë. ¹⁷ Ndë më ke pra pjesëtar, prit-e atë posi mua. ¹⁸ Edhe ndë qoftë se të ka bërë ndonjë paudhëri, a të ka detyrë, këtë numëro-m'a mua. ¹⁹ Unë Pavli shkrova me dorënë t'ime, unë dotë paguanj; që të mos të them, se edhe vetëhenë t'ënde m'a ke detyrë. ²⁰ Po, o vëlla, makar të marr unë prej teje këtë të-mirë mbë Zotinë; prej zëmërenë t'ime mbë Zotinë. ²¹ Dyke pasurë shpresë se dotë më dëgjonjç shkrova te ti, sepse e di se edhe më tepërë se ç'të them dotë bënjç. ²² Mbë gjithatë kohë bë-më gati edhe vënt për të ndënjurë, sepse shprenj se me anë të të-faluravet t'uaj dotë dhurëtonem ndër ju. ²³ Të faletë me shëndet Epafraj që është rop bashkë me mua mbë Jisu Krishtinë, ²⁴ Marku, Dhimaj, Llukaj, bashkëpunëtorët' e mi. ²⁵ Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht qoftë bashkë me frymënë t'uaj. Amin.